



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

Nr. _____ prot

Data 18/09/2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – PUNË NR. 2

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion i shkolles 9 vjecare "7- Marsi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 45214220-8 - Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare,

LLOJI I PROCEDURËS:

Procedurë e hapur elektronike - Pune.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- Fondi limit i kontratës: 125,844,004 (njëqind e njëzetë e pesëmilionë e tetëqind e dyzetë e katër mijë e katër) lekë, pa TVSH., vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Referuar nenit 39, te Vkm Nr. 285, date 19.005.2021 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik, per Kontrata me celesa ne dore, percaktojme se kjo procedure publike do te jete “me kontratë me çelësa në dorë sipas proces verbalit për argumentimin dhe miratimin e kërkesave të vecanta për kontratat për punë publike, miratuar nga titullari i AK me nr _2360/12 prot , datë 07/09/2026 :

Argumentim I Autoritetit Kontraktor

Në lidhje me përcaktimet në VKM Nr.285/2021 per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 45 ku kërkohet“Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston,autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë,si dhe peshën specifike për secilin kriter,konkretisht,pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e një pasnjëshëm.,vlerësojmë si më poshtë:

Së pari në DST **Kapitulli 4.4**“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomiksht më e favorshme,bazuar në kosto
X

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □□	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise □□	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periodha e garancisë së objektit □□	pikët 5

Kjo kërkesë është bërë në zbatim të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”,të ndryshuar,neni 87 “ Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”ku përcaktohet:

1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomiksht më të favorshme.

2.Oferta ekonomiksht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose koston,duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë koston gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji,**dhe mund të bazohet në raportin më të mire çmim-cilësi**,që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë,**duke përfshirë cilësinë ,aspektet mjedisore dhe/ose social**

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a)cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit ,karakteristikat mjedisore dhe novatore,si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b)organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën,kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;ose

c)shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike,kushtet e dorëzimit,si,përshembull,datën e dorëzimit,procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i koston,gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm përkriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët,furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo faze të ciklit të tyre jetësor,duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a)procesin specifik të prodhimit,ofrimit ose tregtimit të atyre punëve,furnizimeve ose shërbimeve, ose

b)një proces specifik,për një faze tjetër të ciklit të tyre jetësor,edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4.Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomiksht më të favorshme,me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Me qëllim garantimin jo vetëm të çmimit më të ulët, por edhe të cilësisë së realizimit të kontratës, organizimit teknik, afateve të zbatimit dhe qëndrueshmërisë së punimeve.

Kriteret e përdorura janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synojnë identifikimin e operatorit ekonomik që garanton realizim sa më cilësor, efikas dhe në kohë të punimeve.

Ndarja e pikëve është bërë mbi bazën e rëndësisë që secili element ka në realizimin me sukses të kontratës, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit – 20 pikë

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për të organizuar dhe realizuar kontratën brenda afateve të kërkuara.

Vlerësimi i grafikut të punimeve dhe kohës së mobilizimit synon:

- shmangien e vonesave në ekzekutimin e kontratës;
- garantimin e fillimit të menjëhershëm të punimeve;
- sigurimin e një planifikimi realist dhe teknikisht të zbatueshëm.

Pesha prej 20 pikësh konsiderohet proporcionale për shkak se organizimi i punimeve dhe mobilizimi ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e kontratës dhe në interesin publik.

Autoriteti Kontraktor shpalli kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar përkëtë kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin me sukses të cdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precision në kryerjen e punimeve, por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë, ndihmësetj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor por dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të plotë të operatorit ekonomik pjesëmarrës i cili në përfundim do të sjellë rezultate të kërkuara dhe të pritura nga ky autoritet.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

3. Stafi / Organizimi i kompanisë – 15 pikë

Ky kriter vlerëson strukturën organizative dhe kapacitetet njerëzore që operatori ekonomik do të angazhojë për realizimin e kontratës.

Qëllimi është të garantohet se:

- kontrata do të realizohet nga personel i kualifikuar;
- ekziston organizim i qartë teknik dhe administrativ;
- operator ka kapacitete reale për menaxhimin e punimeve.

Pesha prej 15 pikësh është proporcionale me rëndësinë që ka faktori njerëzor në cilësinë dhe sigurinë e realizimit të kontratës. Stafi/Organizimi i Kompanisë, i cili vlerësohet deri në 15 pikë, duke ditur që vetëm një staf i kualifikuar profesional inxhiniero-teknik dhe me përvojën e duhur mund të sjellë rezultate të dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik i cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projek preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë/ekperience të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nën kriteret janë kualifikimi i stafit Kyc dhe eksperiencia në fushën specifike i cili provohet me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organizimën e propozuar

të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social – 10 pikë

Ky kriter mbështetet në parimet e prokurimit të qëndrueshëm dhe synon nxitjen e praktikave që minimizojnë ndikimin negativ në mjedis dhe komunitet gjatë zbatimit të kontratës. Vlerësimi mund të lidhet me:

- menaxhimin e mbetjeve;
- reduktimin e ndotjes akustike dhe pluhurave;
- masat për sigurinë publike;
- organizimin e qarkullimit dhe minimizimin e ndikimit social.

Pesha prej 10 pikësh është në raport të drejtë me rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit dhe interesit publik gjatë realizimit të punimeve.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojmë në mjedis dhe në komunitetin tone të përbashkët pozitivisht/negativisht.

Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe **parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit.**

Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një vepre mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, florë dhe faunë, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj.

Në veçanti duhet t'i kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikime të paraqitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe **të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.**

Për të gjitha këto elemente operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë **Propozime konkrete** se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të çdo operatori ekonomik ofertues.

Nënkriteret për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

1. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin)/të ricikluara/efiçente/ material që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.

2. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projecti si një iniciative sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

5. Periudha e garancisë së objektit – 5 pikë

Periudha e garancisë vlerësohet si element që lidhet me qëndrueshmërinë dhe cilësinë afatgjatë të punimeve.

Dhënia e pikëve për një periudhë garancie më të favorshme synon:

- sigurimin e cilësisë së punimeve;
- reduktimin e riskut për defekte pas përfundimit të kontratës;
- rritjen e përgjegjshmërisë së operatorit ekonomik.

Një rëndësie të vecantë i është dhënë edhe **Periudhës së garancisë së objektit** e cila tregon jetëgjatësinë e objektit, faktin se sa më maksimale të jetë **periudha që përfshin garancinë e veprës**, e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final **realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj**.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78,pika 2 të VKM Nr.285datë19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoritetit Kontraktor,ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a) *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të **balanceve të 3 (tri)** viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

***Shëminj:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël””.*

2. Kopje të deklarimit të **xhiros vjetore gjatë 3 (tri)** viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 125,844,004 (njëqind e njëzetë e pesëmilionë e tetëqind e dyzetë e katër mijë e katër) lekë, pa TVSH *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe kestet e matuara për vitin 2026 lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e

vetëqeverisjes vendore sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) gjendjen ekonomike dhe financiare; Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, paragrafi 1 dhe 2 gërma “b”, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfashtimet për veprimtaritë e veçanta, me

propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922 datë 29.12.2014 “*Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*”. Në këto kushte, vlerësojmë të kërkojmë këtë dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar si dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **_62,922,002_** (gjashtëdhjetë milionë e nëntë qind e njëzet e dy mijë e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **215,688,008 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetë) lekë pa TVSH.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtem:

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtare.
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.
- c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazen e tenderimit.

d) Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, **janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës**. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm, që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët të jenë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e

duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedurë.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoritetit të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve ekonomikë e shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE. Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Dokumentacioni si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrëveshje kontraktuale me disponuesit e këtyre licencave, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

<i>Kat. 2 Projektues arkitekt</i>	<i>- Pika b-2, c, d</i>
<i>Kat. 3 Projektues konstruktor</i>	<i>- Pika a, b-1, b-2 c-1, c-2</i>
<i>Kat. 4 Projektues instalator</i>	<i>- Pika a, b, c, f, h, j</i>
<i>Kat. 5 Projektues vepra hidraulike</i>	<i>- Pika b</i>
<i>Kat. 8 Projektues gjeodet</i>	<i>- Pikat a, b, c, d, e</i>
<i>Kat. 9 Studim gjeologo inxhinierik - hidrogeologjik</i>	<i>- Pika a, b</i>
<i>Kat. 10 Projektim impianteve ... të shpërndarjes elektrike</i>	<i>- Pika e</i>
<i>Kat. 12 Studime të sismologjisë inxhinierike</i>	<i>- Pika b</i>

Argumentimi: Këto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak, specifikimet teknike dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktojë disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të leshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Per punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P-1 A Punime gërmimi në tokë;

- N.P-2 B Ndërtime civile dhe industriale;

- N.P-3 B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

Per punimet speciale të ndërtimit:

- N.S-1 A *Punime për prishjen e ndërtimeve;*
- N.S-2 A *Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;*
- N.S-4 B *Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;*
- N.S-12 A *Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;*
- N.S-13 A *Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;*
- N.S-14 A *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV etj.*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “*Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet: “*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 e ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për

kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit për kategoritë respektive është kërkuar duke u bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, të ndryshuar.

NP – 1A *Punime germimi ne toke*

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime gërmimi, sistemimi të dherave etj. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gërmimit, dheut etj., kapitulli mbi punime ndërtimore, elektrike dhe hidraulike sipas preventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

NP – 2B *Ndërtime civile dhe industriale*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderrur, betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse,

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime civile, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime ndërtimore sipas preventivit. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NP – 3B *Rikonstruktion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada*

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime rikonstruksioni, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime ndërtimore sipas peventivit. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NS – 1A *Punime për prishjen e ndërtimeve*

Konsiderohen çmontimin e impianteve industriale dhe prishjen komplet të ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime prishje, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime ndërtimore sipas peventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NS – 2A *Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre*

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime te instalimeve hidraulike sanitare dhe te mbrojtjes ndaj zjarrit, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime hidrosanitare dhe MNZ sipas peventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NS – 4B *Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metali dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese*

Konsiderohen ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime rifiniture, murature, dyer dhe dritare etj., të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime ndërtimore sipas peventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NS – 12A *Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit*

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punime murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime te instalimit te sisitemit te kondicionimit, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime kondicionimi sipas peventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NS – 13A *Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni*

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime te linjave te internetit, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime elektrike sipas peventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

- NS – 14A *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV etj.*

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar parashikon punime te

instalimeve elektrike, të tilla punime përfshihen në zërat e kapitullit mbi punime elektrike sipas preventivit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e parashikuar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Për të stafit inxhinierik drejtues teknik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Arkitekt;
- 1 (një) Inxhinier i specializuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit.
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Markshnajder/ Gjeomatike
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Për stafin e mësipërm inxhinierik duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.*

Për Drejtuesin Teknik Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Kontrata e punës e vlefshme
- b. Diploma
- c. Cv

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit referuar Udhezimit nr.2 date 13.05.2005).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën **40 (dyzetë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).*

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi/çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

- **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë pjesë të punonjësit të mësipërm).

- **1 (një) Inxhinier të çertifikuar nga prodhuesi si i kualifikuar për instalimin e sistemit ngrohje – ftohje** (edhe nepermjet kontraktimit)

Për inxhinierin të çertifikuar nga prodhuesi si i kualifikuar për instalimin e sistemit ngrohje – ftohje, të paraqitet çertifikate e lëshuar nga prodhuesi si dhe kontrata e punës. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet përkatëse.

- Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar **mjekun** e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen dhe /ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të percaktuar me aktmarrëveshje

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

a) Staf Teknik

- Jo më pak se 1 (një) punonjës Teknik ndertimi
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Teknik Elektrik
- Jo më pak se 1 (një) punonjës për dritare
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Hidraulik
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Termo-hidraulik
- Jo më pak se 1 (një) punonjës të sistemeve ngrohje-ftohje
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Saldator për tubacionet/linjat e bakrit
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Suvatues
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Punime Guri Murator
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Bojaxhi
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Elektriçist
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Saldator
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Pllakashtrues
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Murator
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Gipsi
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Karpentier
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Hekurkthyes
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Konstruksiometalike – montator
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Punime në lartësi
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Hidroizolues
- Jo më pak se 4 (katër) punonjës të thjeshtë

d. Punonjës Manovrator

- Jo më pak se 1 (një) Eskavatorist
- Jo më pak se 1 (një) Shofer
- Jo më pak se 1 (një) Automekanist

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që operatori ekonomik duhet të disponojë stafin teknik të nevojshëm për kryerjen e punimeve, i vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, si dhe dokument që vërteton kualifikimin profesional përkatës (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), të lëshuar nga institucione (shtetërore ose private), të licencuara ose akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën

e Shqipërisë". Stafi teknik i kërkuar duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë, të deklaruara për minimumi 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për punonjës Saldator për tubacionet/linjat e bakrit, Operatori ekonomik duhet të disponojë saldator të kualifikuar për bashkimin me saldim të fortë (brazing) të tubacioneve prej bakri, të certifikuar/kualifikuar sipas standartit EN ISO 13585, ose standart ekuivalent, të vlefshëm.

Për punonjës Saldator, Operatori ekonomik duhet të disponojë saldator të kualifikuar për punime saldimi në materiale metalike, të certifikuar sipas standartit EN ISO 9606 ose standart ekuivalent, të vlefshëm.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm automakinist/eskavatorist duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin parashikohet: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet

në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/entikontraktor kërkon: b) **një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj.** Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe / ose c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;** Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirjen e përcaktuar (afatin e punimeve) tregojnë besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomike, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **40 persona** duke përfshirë edhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë që nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Ndërkohë, me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është **mbi 30,000,000 (tridhjetë milion) në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,** njëësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të **një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt,** të përfshirë në liçensimin e

shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kriteri i vendosur për disponimin e numrit prej mesatarisht të paktën **40 punonjës**, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në këtë përlllogaritje njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, **periudhen 15 muaj**, dhe në perfundim, në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatar, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

Në staf përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtues të mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve, grafikun, llojin dhe natyrën e punimeve që do të kryhen si: gërmime, ngjeshje, sistemime, shtrim tubacionesh, punime për pusetat, hidroizolime, suvatime, punime betoni e betonarmeje, rehabilitimi i sistemeve elektrike, sistemeve të ngrohje ftohje, punime rifiniturash etj, të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit të veprës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoro të punimeve.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e Drejtuesit teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore sipas parashikimeve në preventiv.

Është kërkuar të ketë drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve për anën ndërtimore për punimet civile kryesisht germimi, murature, kontrollin e punimeve të betonit, punime të parashikuara për shtresa, nenshtresa për objektin, hidroizolime dhe punime rifiniture etj.

- **Inxhinier Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve elektrike sipas parashikimeve në preventiv.

Është kërkuar të ketë drejtues teknik Inxhinier Elektrik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve për anën elektrike për punimet kryesisht instalime për ndricimin, panele elektrik, sistem tokezimi, sistem rrufeprites etj.

- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

Është kërkuar të ketë drejtues teknik Inxhinier Hidroteknik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve hidraulike për punimet kryesisht instalime hidro sanitare dhe ngrohje, instalime hidraulike të sistemit MNZ etj.

- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

Është kërkuar të ketë drejtues teknik Inxhinier Mekanik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve mekanike për punimet kryesisht instalime mekanike të sistemit kondicionimi, instalime mekanike të sistemit MNZ etj.

- **Arkitekte** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve arkitektonike lidhur me përputhshmerin me projektin.

Është kërkuar të ketë në staf Arkitekte i cili është përgjegjës për mbikeqyrjen e cilësisë së teknikes së ndërtimit në lidhje me përputhshmerin e projektit.

- Është kërkuar të ketë **Inxhinier i specializuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit** i cili është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t'u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim.

- **Inxhinier Gjeodet/Markshnajder/Gjeomatike** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve topografike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

Është kërkuar të ketë ne staf Inxhinier Gjeodet/Markshnajder/Gjeomatike i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve ce kerkojne matje topografike si sistemiet e jashtme, ndertimi shkalleve te emergjences etj.

- **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve mjedisore për mbrojtjen e mjedisit lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.

Është kërkuar të ketë ne staf Inxhinier Mjedisi pasi për kryerjen e punimeve duke u orientuar pasi ky projekt lidhet me instalimin e linjave hidro sanitare, per garantimin dhe sigurimin e ujit te pishem me standarte dhe cilesi etj, bazuar në parashikimin e preventivit te punimeve.

- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

Është kërkuar të ketë ne staf Inxhinier Hidroteknik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve hidraulike per punimet kryesisht instalime shkarkime te ujrave te zeza dhe te bardha etj.

Gjithashtu, në DST janë përcaktuar edhe kërkesat për punonjësit e kualifikuar që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë ofertues për realizimin e këtij objekti. Janë kërkuar punonjës të specializuar dhe të certifikuar me qëllim realizimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën. Në kriterin për punonjës të specializuar/të kualifikuar është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë të punësuar teknik për kryerjen e punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit. Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar / certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh.

Konkretisht janë kërkuar:

- Jo më pak se 1 (një) punonjës Teknik ndertimi
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Teknik Elektrik
- Jo me pak se 1 (një) punonjes per dyer dritare
- Jo me pak se 1 (një) punonjes Hidraulik
- Jo me pak se 1 (një) punonjes Termo-hidraulik
- Jo më pak se 1 (një) punonjës të sistemeve ngrohje-ftohje
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Saldator për tubacionet/linjat e bakrit

- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Suvatues
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Punime Guri Murator
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Bojaxhi
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Elektriçist
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Saldator
- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Pllakashtrues
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Murator
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Gipsi
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Karpentier
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Hekurkthyes
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Konstruksione metalike – montator
- Jo më pak se 1 (një) punonjës Punime në lartësi
- Jo më pak se 1 (nje) punonjës Hidroizolues
- Jo më pak se 4 (katër) punonjës të thjeshtë

Teknik ndërtimi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve duke patur parasysh punimet ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivit. punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to dhe ndërtojnë duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. janë të domosdoshëm për të ndjekur nga afër ecurinë e vazhdueshme të punës në objekt gjatë të gjitha fazave si: punimet germimi, murature, kontrollin e punimeve të betonit, punime të parashikuara për shtresa, nenshtresa për objektin, hidroizolime dhe punime rifiniture etj. Ky specialist është i nevojshëm gjatë zbatimit të punimeve konkretisht në punimet civile të objektit, etj;

Teknik Elektrik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve duke patur parasysh punimet elektrike që do të kryhen sipas zërave të preventivit.. janë të domosdoshëm për të ndjekur nga afër ecurinë e vazhdueshme të punës në objekt gjatë të gjitha fazave si: instalime tubo elektrike, kuti elektrike, panele elektrike, instalime kablllo dhe percjelles elektrik, kanalina metalike, sistemet e ndricimit etj. Ky specialist është i nevojshëm gjatë zbatimit të punimeve konkretisht në punimet elektrike të objektit, etj;

Specialist për dyer/dritare, është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve dyer, dritare, vetrata gjatë zbatimit të punimeve të objektit të parashikuara në preventiv etj.

Hidraulikë, është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike instalimit të linjave shpërndarëse kryesore, rakorderive dhe paisjeve hidraulike në procesin e marrjes, dhe shpërndarjes së ujit, montimin e komplet rakorderive dhe paisjeve hidraulike dhe hidrosanitare të parashikuara në preventiv etj.

Termo Hidraulikë, është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike instalimit të linjave termo hidraulike , rakorderive dhe paisjeve hidraulike dhe shpërndarjes së ujit, montimin e komplet rakorderive dhe paisjeve hidraulike dhe hidrosanitare të parashikuara në preventiv etj.

Specialist sisteme ngrohje ftohje, eshte i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te sistemit ngrohje ftohje te kondicionimit te parashikuara ne preventiv etj.

Saldatore per tubacionet/linjat e bakrit, eshte i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te saldimit te tubacioneve te linjave te bakrit te sistemit ngrohje ftohje te kondicionimit te parashikuara ne preventiv etj.

Suvatues janë te nevojshem për të realizuar punime suvatimi si suva solete, suva brenda mur tulle, suvatim me grafiato te parashikuara ne preventiv etj.

Specialist punime Guri Murator është kërkuar për të realizuar punime murature si mure me blloqe betoni, trotuare, bordura te parashikuara ne preventiv etj.

Bojaxhi janë te nevojshem për të realizuar punime bojatisje si lyerje me boje vaji siperfaqe metalike, lyrje me boje hidroplastike te parashikuara ne preventiv etj.

Elektracist janë te nevojshem për të realizuar punime elektrike si instalime tubo elektrike, kuti elektrike, panele elektrike, instalime kablo dhe percjelles elektrik, kanalina metalike, sistemet e ndricimit te parashikuara ne preventiv etj.

Saldator janë te nevojshem për të realizuar punime saldimi si saldime ne materiale metalike, shkallet e emergjences te parashikuara ne preventiv etj.

Pllakashtrues janë te nevojshem për të realizuar punime pllakash si veshje me pllaka majolike, shtrim me pllaka porcelanat, shtrim me pllaka mermeri te parashikuara ne preventiv etj.

Murator është kërkuar për të realizuar punime murature si mure me tulla te lehtesuara, mur me tulla me 6 vrima te parashikuara ne preventiv etj.

Specialist Gipsi është kërkuar për të realizuar punime gipsi si veshje muri me kartonxhes, veshje tavani me kartonxhes te parashikuara ne preventiv etj.

Karpentier është kërkuar për të realizuar punime betoni si mure betony C 12/15, themel e xokol betony C12/ 15, shtresa betony te parashikuara ne preventiv etj.

Hekurkthyes janë kërkuar për të realizuar punime hekur betoni si hekur betoni i zakonshem Ø >12 mm, hekur betoni i zakonshem Ø 6-10 mm te parashikuara ne preventiv etj.

Specialist Konstruksiione metalike-montator është kërkuar për të realizuar punime montimi konstruksiione metalike si montime konstruksiione metalike per shkallen e emergjences te parashikuara ne preventiv etj.

Specialist Punime ne lartesi është kërkuar për të realizuar punime ne lartesi si punime ne fasad, tarac, shkalle emergjence te parashikuara ne preventiv etj.

Hidroizolues është kërkuar për të realizuar punime hidroizolimi si hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama, hidroizolim me dy komponentesh A+B te parashikuara ne preventiv etj.

Për Punonjes Manovrator

- Jo me pak se 1 (një) Eskavatorist
- Jo me pak se 1 (një) Shofer
- Jo me pak se 1 (një) Automekanist

Eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike të preventivit mbi drejtimin e automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor për mjetet me goma, eskavator gërmimi e ngarkimi dherash dhe me zinxhirë të përfshira në kriteret e kualifikimit.

Shofer për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, referuar zerave të preventivit mbi transport të materiale ndërtimi.

Automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike të preventivit mbi drejtimin Makineritë e rënda të ndërtimi, automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor si autobetoniere.

Për kriterin ku kerkohet Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi/certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
- **1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit:

„Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sic përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.* Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas çertifikimit përkatës shmang dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funksioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

- **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 *“Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”*, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë pjesë të punonjësit të mësipërm).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, *“Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”*, ku citohet se : *“Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep çertifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”*.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**.

- **1 (një) Inxhinier të çertifikuar nga prodhuesi si i kualifikuar për instalimin e sistemit ngrohje – ftohje** (edhe nepermjet kontraktimit)

Për inxhinierin të çertifikuar nga prodhuesi si i kualifikuar për instalimin e sistemit ngrohje – ftohje, të paraqitet çertifikate e lëshuar nga prodhuesi si dhe kontrata e punës. Në rast se oferta

parqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet përkatëse.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve të cilat kanë kompleksitet teknik të sistemit, siguri dhe funksionim i vazhdueshëm kërkohet një specialist i certifikuar nga prodhuesi si i kualifikuar për instalimin e sistemit ngrohje-ftohje prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (një) Inxhinier të certifikuar nga prodhuesi si i kualifikuar për instalimin e sistemit ngrohje – ftohje**

- Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar **mjekun** e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen dhe /ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuar me aktmarrëveshje

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa e mësipërme bazohet në *Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.***Konkretisht:**

Mjekun i shoqërise ose mjek i kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjeku të jete i pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë për të siguruar garancinë në ecurinë e punimeve.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
-----	--------------------	----------	--------	-------

1	Kamion me vinç	Pronesi ose me qira	Copë	2
2	Kamioncin	Pronesi ose me qira	Copë	1
3	Fadromë kovë para dhe mbrapa	Pronesi ose me qira	Copë	1
4	Minifadrome	Pronesi ose me qira	Copë	1
5	Dumper me targa	Pronesi ose me qira	Copë	1
6	Minieskavator me zinxhirë	Pronesi ose me qira	Copë	1
7	Autobetoniere	Pronesi ose me qira	Copë	1
8	Autopompe	Pronesi ose me qira	Copë	1
9	Vinç me Kosh	Pronesi ose me qira	Copë	1
10	Pirun	Pronesi ose me qira	Copë	1
11	Platformë ngritëse	Pronesi ose me qira	Copë	1
12	Betoniere kantieri	Pronesi ose me qira	Copë	2
13	Lidhëse Hekuri	Pronesi ose me qira	Copë	1
14	Armatur dërrase (kalleperi)	Pronesi ose me qira	M2	100
15	Gjeneratorë mbi 50 kva	Pronesi ose me qira	Copë	1
16	Vibrator betoni	Pronesi ose me qira	Copë	2
17	Matrapik me Benzine	Pronesi ose me qira	Copë	2
18	Depozita Uji 5000 L	Pronesi ose me qira	Copë	1
19	Nivelues Helikopter	Pronesi ose me qira	Copë	1
20	Mastar Nivelus	Pronesi ose me qira	Copë	2
21	Kompresor	Pronesi ose me qira	Copë	1

22	Prerese Betoni	Pronesi ose me qira	Copë	1
23	Sharre mermeri	Pronesi ose me qira	Copë	1
24	Elektrovinç	Pronesi ose me qira	Copë	2
25	Zmerilues muri	Pronesi ose me qira	Copë	1
26	Perzires Kolle	Pronesi ose me qira	Copë	1
27	Pompe elektrike lyerje boje	Pronesi ose me qira	Copë	1
28	Skela	Pronesi ose me qira	M2	500
29	Pompe suvatimi	Pronesi ose me qira	Copë	1
30	Motopomp uji	Pronesi ose me qira	Copë	1
31	Tokmak	Pronesi ose me qira	Copë	1
32	Paisje për testimin e tubave	Pronesi ose me qira	Copë	1
33	Paisje për ngjitjen e tubave plastikë	Pronesi ose me qira	Copë	1
34	Balon ndriçimi	Pronesi ose me qira	Copë	2
35	Sondë ispektimi me kamera	Pronesi ose me qira	Copë	1
36	Aparat për saldim të harkuar (SMAË), pajisur me çertifikatë kalibrimi të vlefshme	Pronesi ose me qira	Copë	1
37	Aparat saldimi mig, mag 500A, pajisur me çertifikatë kalibrimi të vlefshme	Pronesi ose me qira	Copë	1
38	Megaohmeter 1000 volt	Pronesi ose me qira	Copë	1
39	Multimeter dixhital 1000VDC 750VAC CAT IV	Pronesi ose me qira	Copë	1
40	Dare ampermetrike 1500A	Pronesi ose me qira	Copë	1
41	Indikator i sensit te fazave	Pronesi ose me qira	Copë	1

42	Tester elektrik multifunksional 200A/1000V AC/DC	Pronesi ose me qira	Copë	1
-----------	---	---------------------	------	---

- Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

Nr	Mjete mbrojtese	Njesia	Sasia
1	Kuti e ndihmes se shpejte	cope	5 copë
2	Tabela sinjalistike e perkohshme per menaxhim trafiku	cope	10 copë
3	Helmata pune, kokore	cope	40 copë
4	Jelek pune fosforeshent	cope	40 copë
5	Fikëse zjarri të lëvizshme	cope	5 copë

- Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); të vlefshme. Për mjetet me qera, të paraqiten dokumentet e mesiperme që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); të vlefshme dhe keto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë noteriale të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit. Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shitblerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme. Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

(Në rastin e mjeteve të marra me qira nga operatorët ekonomikë bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate të transportit të mallrave), mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretet)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe

profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon.. mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njesia e prokurimit vendosi të kërkojë që operatorët ekonomike t'i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve / makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, njesia është bazuar tek zërat dhe volumet e preventivit parashikues. Mjetet e kërkuara përkrijnë me proceset ndërtimore dhe janë përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon çertifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njesia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Mjetet kamiona me vinc dhe kamioncina, damper janë kërkuar për transportin e dherave, inerteve të ndërtimit gjatë prishjeve apo materialeve që do të dalin gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për transportimin e materialeve që do të furnizohen me qëllim realizimin e veprës. Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamiona me vinc dhe kamioncina me kapacitet mbajtës të ndryshëm. Ky numër është i nevojshëm në raport edhe me vëllimin e materialeve.

Mjetet minieskavator me zinxhire, minifadrome dhe fadrome kove para mbrapa janë kërkuar për punimet si gërmime kanalesh, gërmime dheu, sisteme, etj gjatë zbatimit të projekt preventivit. Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të gërmimeve të dheut, nevojitet përdorimi i mjeteve për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet.

Mjeti Prerëse betoni është kërkuar për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv ku përfshihen punime prishje shtresa betoni, prishje mure beton arme etj.

Autobetoniere, autopompe, janë kërkuar për realizimin e punimeve që kanë të bëjnë me betonin dhe beton arme me qëllim ruajtjen e markës së betonit sipas specifikimeve teknike. Duke qenë se transportimi i betonit, kërkon procese dhe makineri specifike siç është autobetonierja, nisur nga sasia e punimeve të betonit dhe betonarmesë në preventiv është kërkuar një mjet.

Pajisje për ngjitjen e tubave plastike, Pajisje për testimin e tubave janë kërkuar për realizimin e instalimeve të tubave hidraulike . Elektrovinc, është kërkuar pasi do të shërbejë për ngritjen e materialeve të ndryshme në lartësi në kate. Sonde inspektimi me kamer është kërkuar për inspektimin e linjave ekzistuese që nuk do të preken.

Aparat për saldim të harkuar (SMAË), pajisje me certificate kalibrimi të vlefshme dhe aparat saldimi mig, mag 500A, pajisur me certificate kalibrimi të vlefshme janë kërkuar për saldimin e konstruksioneve metalike të kërkuara në preventivin parashikues.

Tokmak është kerkuar për realizimin e ngjeshjes së shtresave në sistemimet e jashtme sipas preventivit parashikues.

Motopompe uji është kerkuar për furnizimin me ujë në kate gjatë fazës së ndertimit për punimet ndertimore sipas preventivit parashikues. Pompe suvatimi është kerkuar për të realizuar punimet e suvatimit.

Pompe elektrike lyerje boje është kerkuar për të realizuar lyrjen me boje të mureve tavanëve dhe fasadës së objektit. Sharre mermeri është kerkuar për të realizuar punimet e mermerit për shkallë davanciale etj. Të parashikuara në preventive.

Zmerilues muri është kerkuar për zmerilimin e mureve pas suvatimit duke krijuar një sipërfaqe me të lëmuar.

Matar nivelues, nivelues helikopter janë kerkuar për të realizuar punimet e shtresave niveluse sipas preventivit parashikues. Gjenerator mbi 50 kva është kerkuar për të furnizuar pajisjet e punës me energji elektrike dhe për testimet e sistemeve.

Armature derrase (kalleperi) është kerkuar për të realizuar punimet e beton armës sipas preventivit parashikues.

Lidhese hekuri është kerkuar për të realizuar lidhjen e hekurit të ndertimit sipas preventivit parashikues.

Betoniere kantieri, perziresh kolle janë kerkuar për përgatitjen e materialeve të ndertimit sipas proceseve të parashikuara në preventive. Pirun është kerkuar për ngarkim shkarkimin e materialeve të rendit të parashikuara në preventive. Vinc me kosh, platforme ngritëse është kerkuar për punime në lartësi si punime në fasadë, tavanë, shtylla ndricimi etj. Të parashikuara në preventive.

Matrapik me benzine janë kerkuar për të realizuar punimet e prishjes të suvatimit, mure tulle, mure beton arme, shtresa etj.

Megaohmometer 1000 volt është kerkuar për matjen e rezistencës së tokezimit në rrjetin e tokezimit të sapo instaluar ose në rrjetin ekzistues për të vlerësuar parametrat e rezistencës në baza të normave të lejuara. Multimeter dixhital 1000VDC 750VAC CAT IV është kerkuar për matjen e rrymave të punës dhe tensionit nominal për të përcaktuar ngarkesat e paneleve elektrike. Darrë ampermetrike 1500A është kerkuar për matjen e rrymave në panelet elektrike gjatë punimit në ngarkesë të plotë. Indikator i sensit të fazave është kerkuar për të përcaktuar krahun e rrotullimit të fazave në instalimet elektrike të cilat furnizojnë pajisje të cilat përdorin motor elektrik si përsëmbull kondicioner, pompa etj. Tester elektrik multifunksional 200A/1000V AC/DC është kerkuar për testimet të shpejta të rrymës dhe tensionit.

Në lidhje me mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit janë kerkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantiere” dhe numrit të punonjësve të kerkuar në këtë procedurë prokurimi.

2.3.9 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësive **ISO 9001:2015** (ose ekuivalente) (e vlefshme).

- b. Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit **ISO 14001:2015** (ose ekuivalente) (e vlefshme).
- c. Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune **ISO 45001:2018** (ose ekuivalente) (e vlefshme).
- d. Certifikatë **ISO 50001** - 2011 (ose e përditësuar) mbi “Sistemin e menaxhimit te energjisë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

-Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

-Certifikatë ISO 14001-2015 “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit” kërkohet pasi angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi, kurse metoda më efikase për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistem menaxhimi për mjedisin konform me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Kërkesa lidhur me certifikimin ISO 14001:2015 është bërë, pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontratës. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

-Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë e përditësuar **Certifikatë ISO 45001-2023**, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.

-Certifikatë ISO 50001 - 2011 (ose e përditësuar) mbi “Sistemin e menaxhimit të energjisë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi në monitorimin dhe kontrollin e konsumit të energjisë, përmirësimin e vazhdueshëm të eficiencës energjitike, reduktimin e kostove të energjisë dhe të ndikimit mjedisor dhe përcaktimin e objektivave dhe planeve konkrete për përdorimin me efikas të energjisë.

Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj çertifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

2.3.10 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në zërat e preventivit, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Hidroizolues (dy komponente A+B, katrama)
- Gips
- Bojera
- Sistem kapote (polisterol, kolle, rrjete, grafiato)
- Pllaka
- Materiale elektrike
- Materiale hidraulike
- Pompa MNZ, Hidrant zjarri mural, Fikse zjarri
- Sistem kondicionimi VRF (njësi të brendshme tip kasete, njësi të jashtme, tuba bakri)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

(Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventiv të objektit të prokurimit dhe Nkontratës së bashkëpunimit të nënshkruar).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin të dokumentacionit të paraqitur gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga njësia e prokurimit, pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementët më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve: Hidroizolues, gips, bojera, sistem kapote, pllaka, materiale elektrike, materiale hidraulike, pompa MNZ, hidrant zjarri mural, fikse zjarri, sistem kondicionimi VRF që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti kontraktor ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me Prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit apo certifikimeve të ndryshme sipas kriterit të sipercituar është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave të përdorura në këtë projekt. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen në realizimin e projektit të ujesjellsit. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti Kontraktor ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallrat e planifikuara. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Ky kriter përmbushet edhe nëpërmjet një kontrate noteriale shërbimi/bashkëpunimit të nënshkruar, për licencën e sipercituar. Operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme në SPE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri*”.

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*”

NJËSIA E PROKURIMIT

Julinda Karteri person pergjegjes

Amarildo Fejzulla antar

Lorenc Facja antar